

20251984013

Në bazë të nenit 50 paragrafi (3) të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 24/21 dhe 39/25), Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve miratoi

RREGULLORE PËR MËNYRËN E ZBATIMIT TË VLERËSIMIT TË RREZIKUT SERIOZ PËR JETËN DHE INTEGRITETIN FIZIK DHE PSIKOLOGJIK TË VIKTIMËS DHE ANËTARËVE TË FAMILJES SË SAJ DHE TË RREZIKUT TË PËRSËRITJES SË DHUNËS, MENAXHIMIT TË PËRSHTATSHËM TË RREZIKUT, ZBATIMIT DHE MONITORIMIT TË MASAVE PËR MBROJTJEN E GRAVE VIKTIMA TË DHUNËS NË BAZË GJINORE DHE VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE TË NDËRMARRA NGA QENDRA PËR PUNË SOCIALE DHE FORMULARËT E NEVOJSHËM

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Lënda

Neni 1

Kjo rregullore përshkruan mënyrën e zbatimit të vlerësimit të rrezikut serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe psikik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj dhe të rrezikut të përsëritjes së dhunës, menaxhimit e duhur të rrezikut, zbatimit dhe monitorimit të masave për mbrojtjen e grave viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje, të ndërmarra nga Qendra për Punë Sociale (në tekstin e mëtejshëm: Qendra) dhe formularët e nevojshëm.

Neni 2

Zbatimi i vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut dhe monitorimi i masave për mbrojtjen e grave viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje nga neni 1 i kësaj rregulloreje, nga profesionistët në qendër, kryhet me urgjencë, me vëmendjen e duhur ndaj nevojave dhe të drejtave të viktimës brenda kompetencave të qendrës, si dhe në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet që kryejnë veprimtari në fushën e mbrojtjes sociale, mbrojtjes së fëmijëve, punëve të brendshme, shëndetësisë, punësimit dhe arsimit, në përputhje me Ligjin.

Mënyra e zbatimit

Neni 3

Zbatimi i vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut dhe zbatimi dhe monitorimi i masave për mbrojtjen e grave viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje (në tekstin e mëtejshëm: viktimat), kryhet nga persona profesionalë në qendër (në tekstin e mëtejshëm: profesionistët), bazuar në kuptimin gjinor të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, dhe ata veprojnë në atë mënyrë që sigurojnë mbrojtjen e viktimës nga riviktimizimi, mbrojnë identitetin dhe të dhënat e saj personale, garantojnë konfidencialitetin e të dhënave dhe informacionit të mbledhur gjatë vlerësimit të rrezikut, zbatimit dhe monitorimit të masave mbrojtëse dhe respektojnë dinjitetin e viktimës.

Profesionistët gjatë ndërmarrjes së masave, aktiviteteve dhe shërbimeve për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave udhëhiqen nga barazia gjinore dhe respektimi i të drejtave njerëzore të viktimave, njohja e dinamikës gjinore të dhunës, ndikimi i formave të dhunës mbi viktimën dhe marrin parasysh marrëdhëniet ndërmjet viktimës, dhunuesit dhe mjedisit të tyre më të gjerë social.

Profesionistët ofrojnë mbështetje dhe mbrojtje të pakushtëzuar për viktimën me qëllim që ta fuqizojnë atë të marrë vendime të pavarura për jetën e saj dhe të marrë masa, aktivitete dhe shërbime për mbrojtje dhe mbështetje.

Profesionistët ndërmarrin masa dhe aktivitete ndaj kryerësit të dhunës për të ndryshuar sjelljen e tij dhe për të parandaluar dhunën në të ardhmen.

Neni 4

Profesionistët, pasi e informojnë viktimën për të drejtat dhe masat e saj mbrojtëse, kryejnë vlerësimin e rrezikut serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe psikologjik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj dhe marrin pëlqimin e viktimës për marrjen e masave mbrojtëse.

Urgjente

Neni 5

Pas marrjes së njohurive për dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunën në familje, si dhe menjëherë pas kontaktit të parë me viktimën, prindin ose kujdestarin, profesionistët jo më vonë se 12 orë pas njohurive të marra, kryejnë vlerësimin e rrezikut serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe psikik të viktimës dhe merren masa për mbrojtjen e viktimës, duke pasur parasysh interesat dhe nevojat e saj, si dhe interesin më të mirë të fëmijës, përkatësisht të personit nën kujdestari.

Informimi i viktimës

Neni 6

Viktima informohet nga profesionistët për të drejtën për shoqërues, për të drejtën për mbrojtje shëndetësore, për të drejtën për ndihmë juridike dhe këshillim, për të drejtën e mbrojtjes sociale, për masat mbrojtëse, për masat e përkohshme të mbrojtjes, për të gjitha shërbimet mbrojtëse dhe mbështetëse në dispozicion, për procedurat e ushtrimit të të drejtave dhe rrjedhën e tyre për të drejtën për t'u informuar për të gjitha çështjet gjatë procedurës, në një mënyrë dhe në një gjuhë në të cilën viktima i kupton të drejtat e tij, pavarësisht nëse viktima shfrytëzon shërbime dhe masa mbrojtëse.

Për fëmijën viktimë e dhunës në familje, përveç të drejtave nga paragrafi 1 i këtij neni, profesionistët marrin të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës në përputhje me ligjin, informojnë fëmijën sipas moshës dhe shkallës së zhvillimit psikofizik për zbatimin e procedurës për rregullimin e marrëdhënieve prindër-fëmijë, për mbikëqyrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore dhe të kujdestarisë, duke respektuar të drejtën e fëmijës për të marrë pjesë në procedura në interes të jetës së e tij, të udhëhequr nga interesi më i mirë i fëmijës.

II. VLERËSIMI I RREZIKUT DHE RREZIKU I PËRSËRITJES SË DHUNËS

Neni 7

Profesionistët, me pjesëmarrjen e viktimës, kryejnë vlerësimin e rrezikut serioz për jetën, integritetin fizik dhe psikik të saj, si dhe për anëtarët e familjes, vlerësimin e gjendjes dhe nevojave të saj, përzgjedhjen e masave dhe shërbimeve të përshtatshme për ndihmën, mbështetjen dhe mbrojtjen e saj në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i përsëritjes së dhunës.

Bazuar në vlerësimin e rrezikut nga paragrafi 1 i këtij neni, planifikimi i sigurisë dhe fuqizimi i viktimës bëhet përmes aplikimit të masave të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut.

Neni 8

Gjatë vlerësimit të rrezikut nga neni 7 paragrafi 1 i kësaj rregulloreje, profesionistët marrin parasysh rrethanat që janë specifike për çdo rast individual.

Profesionistët, gjatë propozimit të masave, aktiviteteve dhe shërbimeve, udhëhiqen nga nevojat individuale të viktimës për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna.

Neni 9

Vlerësimi i rrezikut serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe psikik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj dhe rrezikut të përsëritjes së dhunës, nga profesionistët, bëhet që në kontaktin e parë me viktimën, pas identifikimit të rrezikut, formulimit dhe përshkrimit të qartë të rrezikut të identifikuar, si dhe gjatë ofrimit të ndihmës, mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimës.

Gjatë vlerësimit të rrezikut, profesionistët marrin parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat që mund të rrisin rrezikun e dhunës në të ardhmen ndaj viktimës dhe viktimizimit shtesë të saj, dhe në veçanti:

- dhuna aktuale dhe kërcënimi me dhunë (dhuna fizike, psikologjike, ekonomike, seksuale dhe përdhunimi, ndjekja, ngacmimi seksual dhe ngacmimi seksual nëpërmjet internetit dhe përdorimit të mjeteve të komunikimit elektronik),

- dhuna e mëparshme (nëse autori ka qenë më parë i dhunshëm, nëse ishte i dhunshëm ndaj fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes, nëse është autor i kundërvajtjeve dhe veprave penale, nëse më parë i janë shqiptuar masat e mbrojtjes emergjente apo të përkohshme dhe nëse i ka respektuar apo shkelur ato, dhe veçanërisht nëse kryerësi është larguar nga shtëpia),

- intensiteti dhe dinamika e dhunës (shpeshtësia e dhunës, kërcënimet ndaj viktimës ose anëtarëve të familjes me dhunë ose me armë ose mjete të përshtatshme për sulm, qasja e autorit ndaj armëve, veçanërisht armëve të zjarrit, izolimi i viktimës me kyçe, ndalimi i daljes jashtë, ndalimi i kontaktit me miqtë dhe të afërmit, sjelljet kontrolluese ndaj viktimës, përndjekja, nëse përndjekja pasohet nga kërcënime apo dhunë fizike aktive, kërcënim për vrasje, tentativë për mbytje, detyrim për të bërë diçka kundër vullnetit të saj)

- faktorët që lidhen me qëndrimet personale, vlerat, kushtet dhe sjelljen e kryerësit të dhunës (statusi i punës ose problemet financiare të autorit, përdorimi i alkoolit, drogave dhe substancave të tjera psikotrope, sëmundjet mendore, xhelozia, posesiviteti, tentativat ose kërcënimet për vetëvrasje, kontrolli detyrues dhe manifestimi i pushtetit),

- modelet e sjelljes së kryerësit dhe faktorë të tjerë specifikë për rastin (perceptimet e viktimës për rrezikun dhe frikën e saj, situata e jetës personale dhe mbështetja e disponueshme e viktimës, fëmijët e përbashkët, nëse ai ka qenë i dhunshëm gjatë shtatzënisë së viktimës dhe situata të tjera përkatëse familjare, paaftësia e viktimës dhe çdo faktorë tjetër rreziku që mund të kërcënojnë sigurinë viktimës).

Neni 10

Profesionistët për vlerësimin e rrezikut plotësojnë formularin Pyetësor për vlerësimin e rrezikut serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe mendor të viktimës dhe familjarëve të saj, i cili jepet në shtojcën nr. 1 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

III. MENAXHIMI I RREZIKUT

Pëlqimi i viktimës

Neni 11

Profesionistët, pasi të jetë kryer vlerësimi i rrezikut, i mundësojnë viktimës të shprehë lirisht vullnetin për të ndërmarrë masa për mbrojtje dhe mbrojtje të përkohshme, bazuar në informacionin e marrë për procedurën, qëllimin dhe pasojat e zgjedhjes së masës mbrojtëse dhe mënyrën e zbatimit dhe monitorimit të saj.

Pëlqimi i viktimës jepet me shkrim në formularin Pëlqimi i viktimës për masa mbrojtëse, i cili jepet në shtojcën nr. 2 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 12

Në rast të vlerësimit të ekzistimit të rrezikut serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe mendor të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj, për përsëritje ose rritje të intensitetit të dhunës, me pëlqimin e viktimës nga neni 11 paragrafi 2 i kësaj rregulloreje, profesionistët kryejnë planifikimin e sigurisë së viktimës dhe familjarëve të saj.

Neni 13

Profesionistët planifikojnë sigurinë së bashku me viktimën dhe hartojnë një plan individual për mbrojtjen e viktimës dhe menaxhimin e duhur të rrezikut (në tekstin e mëtejshëm: plani individual).

Gjatë përgatitjes së planit individual, profesionistët marrin parasysh identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut për viktimën dhe anëtarët e familjes së tij dhe parashikojnë marrjen e masave për të ndihmuar dhe mbrojtur viktimën, të cilat janë në dispozicion të viktimës për të rritur sigurinë personale në mënyrë që të parashikohen kërcënimet aktuale dhe afatgjata të sigurisë.

Plani individual plotësohet në formularin Plani individual për mbrojtjen dhe përforcimin e viktimës, i cili jepet në shtojcën nr. 3 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 14

Plani individual është fleksibël dhe i adaptueshëm ndaj rrethanave dhe faktorëve të rrezikut për viktimën, duke marrë parasysh modelet e sjelljes së autorit.

Plani individual është i përshtatatur me realitetin e ndryshëm të secilës viktimë dhe përfshin masa specifike për të menaxhuar rreziqet e vlerësuara, si dhe shërbimet e disponueshme sipas interesave dhe nevojave të tyre, interesit më të mirë të fëmijës përkatësisht personit nën kujdestari.

Plani individual përgatitet përmes një rishikimi gjithëpërfshirës të të gjitha fakteve që ndikojnë në sigurinë e viktimës dhe i përshtatet rrethanave dhe nevojave individuale të viktimës.

Neni 15

Menaxhimi adekuat i rrezikut përfshin zbatimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të masave mbështetëse dhe mbrojtëse të përfshira në planin individual nga profesionistë me pjesëmarrjen aktive të viktimës, që mund të përfshijnë:

- kontaktimin me viktimën në 12 orët e para pas miratimit të planit individual,
- kontaktimin e rregullt me viktimën për kohëzgjatjen e masave të parashikuara në planin individual sipas nevojave të viktimës,
- qasja e viktimës në komunikimin telefonik në rast rreziku të menjëhershëm,
- sigurimin e ekzaminimeve shëndetësore dhe dokumentacionit mjekësor,
- vendosja në një qendër për viktimat e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje,
- udhëzimin në një qendër për viktimat e dhunës seksuale në rast të dhunës seksuale,
- sigurimi i të drejtës për mbrojtje sociale,
- sigurimi i mbështetjes psiko-sociale, dhe këshillimit,
- ofrimi i këshillave juridike dhe ndihmës juridike falas,
- njoftimin e punëdhënësit për dhunën e evidentuar me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunën në familje në rast se dhunuesi ka qasje, gjegjësisht përdor armë zjarri zyrtare në kuadër të kryerjes së detyrave të punës,

- njoftimi i institucionit edukativ-arsimor për rrezikun e dhunës në familje ndaj fëmijëve dhe përsëritjes së dhunës,
- informimin në kohë dhe i plotë ndaj viktimës për rrjedhën e procedurës kundër autorit të veprës para organeve kompetente dhe rezultatit të procedurës, dhe
- marrjen e masave të tjera të nevojshme për t'i dhënë ndihmë viktimës.
- Nëse një fëmijë është viktimë e dhunës, atëherë planifikimi i sigurisë përfshin masa për të ndihmuar dhe mbështetur fëmijën.

Neni 16

Profesionistët monitorojnë dhe vlerësojnë rregullisht efektin e zbatimit të masave mbrojtëse që janë pjesë e planit individual dhe rishikojnë planin individual, vlerësojnë faktorët dhe arsyet që ndikojnë në efektin e masave mbrojtëse, mbi bazën e të cilave ndryshohen dhe propozohen masa të reja për të garantuar sigurinë e viktimës dhe fuqizimin e saj.

Neni 17

Në rast të vlerësimit të ekzistencës së rrezikut për jetën dhe integritetin fizik dhe mendor të grave viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje dhe anëtarëve të familjes, profesionistët mbledhin ekipin e ekspertëve multi-sektorial dhe hartojnë një plan sigurie për mbrojtjen dhe forcimin e viktimës (në tekstin e mëtejshëm: plani i sigurisë).

Neni 18

Plani i sigurisë nga neni 17 i kësaj rregulloreje krijohet me një qasje ndërdisiplinore dhe të integruar, me pjesëmarrjen e viktimës.

Profesionisti fut të dhënat e kontaktit për anëtarët e ekipit të ekspertëve multisektorial në formularin Lista dhe kontaktet e anëtarëve të ekipit multisektorial, i cili jepet në shtojcën nr. 4 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 19

Ekipi i ekspertëve multisektorial, gjatë përgatitjes së planit të sigurisë, nis nga identifikimi i mëparshëm dhe vlerësimi i rrezikut, vlerësimi i nevojës për mbrojtje të viktimës dhe familjarëve të saj, i përgatitur nga qendra, duke marrë parasysh të gjitha njohuritë e anëtarëve të tjerë të ekipit të ekspertëve multi-sektorial që i referohen rrezikut për jetën dhe integritetin fizik dhe mendor të viktimës dhe familjarëve të saj, në bazë të të cilave parashikohen masat e menaxhimit të rrezikut dhe mbrojtjes për viktimën, sipas nevojave të saj.

Në rast të vlerësimit të ekzistimit të rrezikut serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe mendor të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj ose pas marrjes së njoftimit nga punonjësi i policisë për propozimin e paraqitur për caktimin e masës së mbrojtjes emergjente - largimi i autorit nga shtëpia dhe dhe ndalimi i tij për t'iu afruar shtëpisë, me vlerësimin e rrezikut dhe raportin e policisë, eksperti mbledh ekipin e ekspertëve multi-sektorial për planifikimin e sigurisë dhe përgatitjen e planit të sigurisë.

Plani i sigurisë plotësohet në formularin Plani i sigurisë për mbrojtjen dhe përforcimin e viktimës, i cili është dhënë në shtojcën nr. 5 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Në rast se paraqitet propozimi për caktimin e masës së mbrojtjes emergjente - largimi i kundërvajtësit nga shtëpia dhe ndalimi i afrimit në banesë, nga punonjësi policie, i njëjti së bashku me raportin e policisë dhe masat dhe aktivitetet e planifikuara dhe të ndërmarra për menaxhimin e rrezikut, merren parasysh gjatë përgatitjes së planit të sigurisë.

Neni 20

Plani i sigurisë hartohet me rishikim gjithëpërfshirës të të gjitha fakteve që ndikojnë në sigurinë e viktimës dhe anëtarëve të familjes së tij dhe parashikon dhe merr masa, të përshtatura me rrethanat dhe nevojat e viktimës, për të menaxhuar rrezikun.

Nga ekipi i ekspertëve multisektorial, efekti i zbatimit të planit të sigurisë monitorohet dhe vlerësohet rregullisht dhe përshtatet në përputhje me situatën e viktimës për sa i përket masave të menaxhimit të rrezikut, masave të ndihmës dhe shërbimeve të disponueshme.

Gjatë përgatitjes së planit të sigurisë, ekipi i ekspertëve multi-sektorial i mundëson viktimës të marrë vendime në mënyrë të pavarur dhe të shprehë lirshëm vullnetin për të marrë masa për mbrojtje dhe mbrojtje të përkohshme.

Neni 21

Monitorimi i zbatimit të masave të parashikuara në planin e sigurisë kryhet nga anëtari i ekipit të ekspertëve multi-sektorial në kuadër të detyrave të tij, në mënyrë që të paktën një herë në 48 orë të kontaktohet me viktimën në lidhje me zbatimin e masave nga plani i sigurisë në përputhje me nevojat viktimës, i cili evidentohet në formularin Listë për monitorimin e masave mbrojtëse nga plani i sigurisë, i cili jepet në shtojcën nr. 6 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Qendra informohet për rrjedhën dhe efektet e marrjes së masave mbrojtëse nga secili anëtar i ekipit të ekspertëve multi-sektorial në kuadër të detyrave të tij, të paktën një herë në ditë gjatë javës së punës, si dhe sa herë që ka njohuri për rrethana të reja në lidhje me rastin, të cilat anëtari i qendrës i evidenton në Listën e monitorimit të masave mbrojtëse nga plani i sigurisë.

Nga anëtari i ekipit të ekspertëve multi-sektorial nga qendra, pas marrjes së njoftimit nga një anëtar tjetër i ekipit të ekspertëve multisektorial ose nga viktimë për rrethana të reja që tregojnë rrezik të shtuar ose të ri për të rrezikuar jetën dhe integritetin fizik dhe psikologjik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj, thirret menjëherë ekipi i ekspertëve multisektorial për rishikimin e planit të sigurisë.

Ekipi i ekspertëve multi-sektorial vlerëson efektet e masave mbrojtëse në sigurinë e viktimës të paktën një herë në javë, për sa kohë që ekziston rreziku për jetën dhe integritetin fizik dhe psikologjik të viktimës, fëmijës dhe anëtarëve të familjes, si dhe për përsëritjen e dhunës.

Plani i sigurisë pushon së zbatuari kur ekipi i ekspertëve multisektorial, bazuar në një rivlerësim të rrezikut të jetës dhe shëndetit, vlerëson se rreziku është ndalur në lidhje me viktimën dhe anëtarët e familjes.

Tërheqja e pëlqimit

Neni 22

Në rastin e tërheqjes së pëlqimit të viktimës nga neni 11 i kësaj rregulloreje, arsyet e tërheqjes së pëlqimit të dhënë vlerësohen nga ekspertët, ofrohet mbështetje psiko-sociale për të forcuar viktimën për të formuar vullnetin e lirë për përdorimin e masave të ndihmës dhe mbrojtjes.

Në rast se viktimë është fëmijë ose person me aftësi të kufizuar ose të privuar biznesi, masat mbrojtëse merren edhe pa pëlqimin e prindit ose kujdestarit.

IV. ZBATIMI DHE MONITORIMI I MASAVE PËR MBROJTJE

Sigurimi i kujdesit të përkohshëm

Neni 23

Masa e përkujdesjes së përkohshme për viktimën zbatohet me qëllim të mbrojtjes së saj, në rast se pas vlerësimit të rrezikut, vihet re një rrezik i menjëhershëm për jetën dhe integritetin fizik dhe psikologjik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj nga përsëritja e dhunës, ndërsa nuk ka burime në mjedisin familjar dhe social për të pranuar viktimën.

Qendra, në varësi të nevojave të viktimës dhe familjarëve të saj, ofron strehim në një qendër për qëndrim të përkohshëm të një ofruesi të licencuar të shërbimeve sociale, si kujdes i përkohshëm dhe/ose përkujdesje ndërhyrjeje për viktimën.

Pas vendosjes së viktimës në një qendër për qëndrim të përkohshëm, profesionistët zbatojnë planin individual dhe realizojnë masat, aktivitetet dhe shërbimet e planifikuara për ndihmë dhe mbrojtje duke ofruar ndihmë dhe mbështetje psiko-sociale, akses në ndihmë juridike dhe përfaqësim, referim për trajtim për tejkalimin e traumës, përfshirje në masa aktive për punësimin e viktimës me synim përfshirjen në tregun e punës dhe arritjen e pavarësisë financiare dhe shërbime të tjera, sipas nevojave të saj.

Sigurimi që viktima të ushtrojë të drejtën për mbrojtje sociale dhe shëndetësore

Neni 24

Masa për ushtrimin e të drejtës për mbrojtje sociale zbatohet në mënyrë që profesionisti ta informojë dhe ta ndihmojë viktimën në ushtrimin e të drejtave të mbrojtjes sociale dhe sigurimin e dokumentacionit sipas detyrës zyrtare, në përputhje me Ligjin për mbrojtje sociale, dhe ta përcjell viktimën në institucionin përkatës, nëse ka nevojë për këtë.

Profesionisti monitoron masat për realizimin e të drejtës së mbrojtjes sociale, në atë mënyrë që i mundëson viktimës të realizojë të drejtat në varësi të rrethanave të ndryshuara për realizimin dhe shfrytëzimin e së njëjtës.

Neni 25

Masa për ushtrimin e të drejtës për kujdes shëndetësor zbatohet në atë mënyrë që viktima të njoftohet nga profesionisti për të drejtat e tij për të marrë ndihmë mjekësore falas, të ndihmohet në ushtrimin e të drejtës për sigurim shëndetësor, përkatësisht kujdes shëndetësor dhe nëse është e nevojshme, t'i ofrohet trajtimi i duhur mjekësor dhe dokumentacioni mjekësor.

Mbështetja për ofrimin e trajtimit mjekësor dhe dokumentacionit mjekësor përfshin bashkëpunimin dhe komunikimin e drejtpërdrejtë me institucionin shëndetësor përkatës.

Profesionisti e shoqëron viktimën në institucionin shëndetësor përkatës, nëse ka nevojë.

Ndërhyrja dhe trajtimi i përshtatshëm psiko-social

Neni 26

Qendra zbaton masën e ndërhyrjes dhe trajtimin e përshtatshëm psiko-social, duke ofruar ndërhyrje fillestare në krizë, informon dhe inkurajon viktimën të përdorë shërbimet për ndërhyrje psiko-sociale, ndihmë psikologjike, mbështetje dhe/ose trajtim për të përballuar me sukses pasojat e dhunës së mbijetuar.

Masa e ndërhyrjes dhe trajtimit të duhur psiko-social zbatohet përmes këshillimit nga një punonjës profesionist dhe këshillimorja me punën ekipore ndërdisiplinore.

Nga ana e qendrës, viktima mund të referohet për trajtim terapeutik në një këshillimore ose institucion.

Ofrimi i trajtimit psiko-social në këshillimore për gratë viktima të dhunës dhe viktima të tjera të dhunës në familje

Neni 27

Masa për trajtimin psiko-social në këshillimore merret nga profesionistë në qendër ose shoqatë, këshillimore për gratë viktima të dhunës me bazë gjinore dhe viktima të dhunës në familje.

Në këshillimore, zbatohet trajtimi psiko-social në mënyrë konfidenciale, duke respektuar dinjitetin e viktimës, respektimin e diversitetit dhe pa diskriminim.

Në varësi të nevojave të viktimës, qendra e udhëzon viktimën për të shfrytëzuar shërbimin në këshillimore të përshtatshme të një ofruesi të licencuar të shërbimeve sociale.

Ndihma për familjen për shkollimin e rregullt të fëmijës

Neni 28

Për zbatimin e masës së mbrojtjes dhe ndihmës ndaj familjes për shkollimin e rregullt të fëmijës, profesionistët marrin masat e nevojshme për të ndihmuar viktimën për përfshirjen ose vazhdimin e shkollimit të rregullt të fëmijës dhe ndërmerren veprime të tjera të nevojshme për shkollimin e tij të rregullt.

Qendra merr masa për t'i mundësuar fëmijës anëtarësimin ose vazhdimin që të ndjekë një institucioni tjetër parashkollor, në mënyrë që fëmija të vijojë pa ndërprerje kopshtin.

Aktivitetet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni ndërmerren sa herë që viktima ndërron vendbanimin, përkatësisht vendqëndrimin.

Ndihma juridike dhe përfaqësimi

Neni 29

Qendra e zbaton masën e mbrojtjes, ndihmës juridike dhe përfaqësimit duke e informuar viktimën për të drejtat dhe procedurat që mund të iniciojë para gjykatës apo autoriteti kompetent, për tejkalimin dhe parandalimin e dhunës, si dhe udhëzimin e viktimës në njësi rajonale të Ministrisë së Drejtësisë ose në shoqatë të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike falas ose në klinikë juridike të autorizuar.

Përforcimi ekonomik i viktimës nëpërmjet përfshirjes së tij aktive në tregun e punës

Neni 30

Qendra e informon viktimën për mundësitë e fuqizimit ekonomik dhe përfshirjes në tregun e punës, nëpërmjet referimit tek autoritetet dhe organizatat përkatëse, si dhe komunikon dhe koordinohet me të njëjtët për të shfrytëzuar mundësitë për pavarësi ekonomike të viktimës.

Qendra kompetente dhe qendra e punësimit bashkëpunojnë dhe koordinohen për përfshirjen e viktimës në masa aktive për punësim, si dhe për punësimin e saj.

Besimi i përkohshëm i kujdesit dhe edukimit të fëmijëve

Neni 31

Nga ana e qendrës, fëmijës i besohet përkohësisht kujdesi dhe edukimi i prindit që është viktimë, në rast se ekziston rreziku serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe psikik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj dhe rreziku i përsëritjes së dhunës, brenda 12 orëve nga marrja e kallëzimit për dhunën e kryer, pavarësisht nëse ka pëlqim nga prindi tjetër.

Masa nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohet sa herë që ekziston rreziku serioz për jetën, integritetin psikik dhe fizik të viktimës, kur viktimës i sigurohet strehim i përkohshëm ose intervenues, duke pasur parasysh sigurinë dhe sigurinë e fëmijës.

Qendra, e drejtuar nga interesi më i mirë i fëmijës, kufizon ose ndalon përkohësisht marrëdhëniet personale dhe kontaktet e drejtpërdrejta të fëmijës me prindin me të cilin ai nuk jeton së bashku, nëse konstatohet se ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës dhe pasojave të dhunës së kryer.

Monitorimi i masave mbrojtëse

Neni 32

Profesionistët, bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe masat mbrojtëse që përmban plani individual, zbatimi i masave monitorohet nëpërmjet kontakteve me viktimën, personat e tjerë që mbështesin viktimën dhe duke ndërmarrë veprime të tjera të nevojshme, me qëllim monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së viktimës dhe nevojave të saj për ndihmë dhe mbrojtje të mëtejshme.

Neni 33

Nga ana e profesionistëve, aktivitetet, masat dhe shërbimet e ndërmarra futen në planin individual, në pjesën e monitorimit të zbatimit të masave mbrojtëse.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 34

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, pushon së vlefshmi Rregullorja për mënyrën e kryerjes së vlerësimit të rrezikut serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe psikik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj dhe rrezikun e përsëritjes së dhunës, menaxhimin e duhur të rrezikut, zbatimin dhe monitorimin e masave për mbrojtjen e grave viktimë të dhunës me bazë gjinore dhe viktimë të dhunës në familje, të ndërmarra nga Qendra për Punë Sociale dhe formularët e nevojshëm (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 240/21).

Neni 35

Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 17-4122/3
23 shtator 2025
Shkup

Ministri i Politikës Sociale,
Demografisë dhe të Rinjve,
Fatmir Limani, d.v.

Shtojca nr. 1

IP QPS _____

Nr. _____

(Data dhe vendi)

Pyetësor për vlerësimin e rrezikut serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe psikik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj

Emri i viktimës _____

Data _____

1. Informacion rreth dhunës aktuale/kërcënimi me dhunë

	Po	Jo	Nuk mund të vlerësojë	Vërejtje
Viktima informohet dhe shpjegohet se qëllimi i vlerësimit të rrezikut është mbrojtja dhe ofrimi i sigurisë së saj				
Nëse incidenti aktual ka rezultuar me lëndim fizik?				
<i>Tregoni llojin e lëndimit fizik</i>				
Nëse ekziston frika nga përsëritja e dhunës?				
<i>Tregoni se nga çfarë dhe nga kush ka frikë viktima në këtë moment</i>				
A ekziston ndjenja e mungesës së shpresës?				
A ka sjellje kontrolluese nga ana e dhunuesit?				
- izolimi i viktimës përmes mbylljes				
- ndalimi për të dalë jashtë				
- ndalimi i kontaktit me miqtë dhe të afërmit				
- përndjek viktimën, dërgon mesazhe në telefon ose shantazhon viktimën				

- kufizon ose pengon disponimin e të ardhurave personale dhe mjeteve financiare				
<i>Tregoni se si manifestohet</i>				
A ka përdorur autori ndonjë send apo mjet incidentin e fundit me qëllimin për të lënduar viktimën?				
<i>Tregoni se si manifestohet</i>				
Nëse shkelësi në incidentin e fundit ka përdorur armë?				
Nëse shkelësi zotëron apo ka qasje për armë?				
Nëse ekziston përmbajtje kërcënuese në komunikim me viktimën apo sjellje kërcënuese të shkelësit?				
<i>Tregoni se si manifestohet</i>				
A ka kërcënim për përdorimin e armës ndaj viktimës apo anëtarëve të familjes së saj?				
A ka dijeni viktimë se kryesi synon të blejë armë?				
A ekziston frika tek viktimë se arma do të përdoret me qëllim të shkakimit të lëndimit trupor ose vrasjes?				
A ekziston frika tek viktimë se do të përdoret një armë kundër fëmijëve të viktimës dhe/ose anëtarëve të tjerë të familjes, apo për një person të afërt me viktimën				
A ka rrezik për trupin dhe jetën e viktimës apo të një anëtari të familjes së viktimës?				
<i>Tregoni se si manifestohet</i>				
A ka përdorur kryerësi armë për të ushtruar kontroll shtrëngues?				
A kërcënon autori se do të kryej vetëvrasje?				
A përfshihet dhunuesi në ndjekje, përndjekje, ngacmim nëpërmjet ndonjë mjeti komunikimi?				
<i>Tregoni se si manifestohet</i>				
A është dhunuar seksualisht viktimë?				

A e detyroi kryerësi viktimën të kryente marrëdhënie seksuale kundër dëshirës së saj?				
A pranoi viktimë për marrëdhënie seksuale për shkak të frikës nga dhunuesi?				
A ka viktimë forcën për t'u larguar nga një marrëdhënie dhunuese?				
A është larguar viktimë në moment nga marrëdhënia dhunuese apo komuniteti abuziv?				
A është viktimë e varur ekonomikisht nga kryerësi? <i>Nëse po, specifikoni në çfarë mënyre</i>				
A abuzon kryerësi me alkoolin?				
A abuzon autori me substanca psikotrope?				
Çfarë mendon viktimë se do të rrisë ndjenjën e saj të sigurisë?				

2. Të dhëna për dhunën e mëparshme (kohëzgjatja dhe shpeshtësia e dhunës)

2.1. A ka qenë kryerësi më parë i dhunshëm?

PO JO

Nëse PO, tregoni se cilat forma të dhunës janë pësuar _____

2.2. A ishte dhuna e drejtuar edhe ndaj fëmijëve/anëtarëve të tjerë të familjes?

PO JO

Nëse PO, tregoni ndaj cilit _____

2.3. A ka kërkuar ndihmë mjekësore viktimë për lëndimet e saj?

PO JO

Nëse PO, përshkruani se ku dhe me çfarë lëndimesh, _____

2.4. A është denoncuar më parë kryerësi në polici apo se ka dënime të mëparshme?

PO JO Nuk e di

Nëse po, nënvizoni çfarë: dhunë seksuale, dhunë në familje, vrasje, përleshje, të tjera _____

2.5. A është përfshirë më parë kryerësi në ndonjë incident ku është përdorur armë?

2.6. A është shqiptuar më parë ndaj kryerësit një masë e përkohshme mbrojtëse?

PO JO Nuk e di

Nëse është PO, a është, ka një zëvendësim apo ka përfunduar? _____

2.7. Me incidentin e fundit kryerësi a e ka shkelur masën e shqiptuar?

PO JO

Nëse po, cila _____

2.8. Kur filloi dhuna për herë të parë: incidenti i parë, 6 muaj më parë, 1 vit më parë, më shumë se 1 vit, sa _____. (nënvizoni çka korrespondon)

2.9. Sa shpesh ka ndodhur dhuna: incidenti i parë, raste, javore _____, mujore _____, dhe të tjera _____ (nënvizoni çka korrespondon)

2.10. A është zmadhuar dhuna?

PO JO

2.11. Si është manifestuar dhuna e mëparshme? (të përshkruhet duke u nisur nga lloji dhe intensiteti i dhunës fillestare deri te incidenti i fundit)

2.12. A u është kërcënuar kryerësi anëtarëve të familjes së viktimës?

PO JO

2.13. A ndodh dhuna para të afërmeve me të cilët viktima jeton në një familje të përbashkët?

PO JO

Nëse Po, para kujt _____

2.14. A merr kryerësi mbështetje për kryerjen e dhunës nga anëtarët e tjerë të familjes, të afërm ose miq?

PO JO

Përshkruani nga kush _____

2.15. A ka viktima mbështetje dhe mbrojtje nga dhuna nga ndonjë anëtar i familjes ku jeton apo nga miqtë?

PO JO

Nëse Po, tregoni nga kush _____

2.16. A ka viktima mbështetje dhe mbrojtje nga ndonjë i afërm apo nga miqtë?

--

4. Nëse në familje ka fëmijë, plotësoni pyetjet e mëposhtme:

4.1. A vuajnë fëmijët nga dhuna?

PO JO

Nëse PO, çfarë forme dhune:

fizike psikike seksuale tjetër _____
(nënvizoni çka korresponдон)

4.2. A ka viktima konflikte rreth kontaktit me fëmijët??

PO JO

Nëse PO, përshkruani _____

4.3. A është marrë ndonjë vendim për të rregulluar marrëdhëniet personale me fëmijën me të cilin nuk jeton së bashku?

PO JO

4.4. A e shkeli kryesi vendimin për t'u parë me fëmijët?

PO JO

Nëse Po, përshkruani _____

5. Të dhëna mbi vlerësimin profesional të rrezikut të jetës dhe shëndetit të viktimës:

Për profesionistët: A ka ndonjë informacion tjetër relevant nga viktima ose një profesionist që mbështet vlerësimin e rrezikut serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe psikik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj? Merren parasysh rrethanat e viktimave që rrisin cenueshmërinë e tyre, veçanërisht për gratë shtatzëna, gratë me fëmijë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, anëtarët e komuniteteve jo-shumicë, nënat vetëushqyese, gratë me aftësi të kufizuara, gratë nga zonat rurale, gratë që përdorin drogë, punonjëset seksuale, migrantet, refugjatët, azilkërkuesit, gratë pa shtetësi, lezbiket, biseksualët dhe transgjjinorët, gratë që jetojnë me HIV, gratë e pastreha, gratë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore, gratë e moshuara, gratë e pasigurta materialisht ose çdo status apo gjendje tjetër që mund të rrisë cenueshmërinë.

5.1. A mendoni se ka rreziqe për fëmijët në familje?

PO JO

5.2. A mendoni se ka rreziqe për anëtarët e tjerë të familjes së viktimës?

PO JO

5.3. Cilat janë prioritetet kryesore për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e viktimës?

5.4. A mendoni se ky rast duhet të trajtohet nga ekipi profesional multisektorial?

PO JO

Nënshkrimi:

Data:

Emri dhe mbiemri i profesionistit

Nëse PO, konfirmoni se është mbledhur ekipi professional multisektorial
Data e mbledhjes së ekipit profesional multisektorial: _____

Nënshkrimi:

Data:

Emri dhe mbiemri i profesionistit

Vërejtet e profesionistit

IP QPS_____

Shtojca nr. 2

Nr. _____

(Data dhe vendi)

Pëlqimi i viktimës për masat mbrojtëse

1. Të dhëna për informimin e viktimës rreth të drejtave të saj

Jam plotësisht i/e informuar për të drejtat e mëposhtme:		Vërejtje
1.	E drejta për shoqërues	
2.	E drejta për mbrojtje shëndetësore	
3.	E drejta për keshillim dhe përfaqësim juridik dhe ku të drejtohem	
4.	E drejta për mbrojtje sociale _____ _____ _____ _____ _____	
5.	E drejta për t'u informuar në mënyrën dhe gjuhën që e kuptoj, përfshirë gjuhën e shenjave,	
6.	Rreth procedurave për ushtrimin e të drejtave dhe progresin e tyre	
7.	E drejta për t'u informuar rreth të gjitha çështjeve gjatë procedurave	

Nënshkrimi i viktimës

Nënshkrimi i profesionistit

2. Të dhëna për informim për masat mbrojtëse

Jam plotësisht i/e informuar për masat e mëposhtme të mbrojtjes dhe shërbimet e disponueshme të ndihmës dhe mbrojtjes		Nënshkrimi i viktimës	Data	Vërejtje
1.	Akomodimi në qendër për personat- viktimë të dhunës në familje			
2.	Kujdes shëndetësor i përshtatshëm			
3.	Ndërhyrje dhe trajtim i përshtatshëm psiko-social			
4.	Trajtim psiko-social në këshillimore			
5.	Udhëzim në një qendër për viktimë të dhunës seksuale			
6.	Mbështetje për familjen për shkollimin e rregullt të fëmijës			
7.	Ndihma dhe përfaqësimi juridik			
8.	Fuqizimi ekonomik i viktimës përmes përfshirjes së saj aktive në tregun e punës			

3. Pëlqimi i viktimës për zbatimin e masave mbrojtëse

Konfirmoj se e kam lexuar dhe e kam kuptuar informacionin të cilin e kam marrë në lidhje me të drejtat dhe masat mbrojtëse. Kam marr shpjegime të kënaqshme që më kanë mundësuar të kuptoj procedurën, qëllimin e masës/masave për mbrojtje si dhe për zbatimin

dhe monitorimin. Jam e informuar se mund te tërheq pëlqimin tim ne çdo kohë pa pësuar pasjoa për këtë.

SHPREH PËLQIMIN për zbatimin dhe ndjekjen e msasës/masave të mëposhtme

(masën/masa për mbrojtjen)

Nënshkrimi i viktimës

Emri dhe mbiemri

Nënshkrimi i profesionstëve:

Emri dhe mbiemri _____

Emri dhe mbiemri _____

Emri dhe mbiemri _____

Data dhe vendi

Jam e informuar dhe SHPREH PËLQIMIN për mbledhjen e ekipit profesional multisektorial dhe zbatimin e planit të sigurisë për mbrojtje

Nënshkrimi i viktimës

Emri dhe mbiemri

Nënshkrimi i profesionistit:

Emri dhe mbiemri _____

Data dhe vendi

IP QPS _____
Nr. _____

Shtojca nr. 3

(Data dhe vendi)

Plani individual për mbrojtjen dhe fuqizimin e viktimës

Informimi dhe pëlqimi i viktimës për planin individual për mbrojtjen dhe fuqizimin e viktimës

A është viktimë e informuar për planin individual për mbrojtjen dhe fuqizimin e viktimës dhe përmbajtjen e tij?

PO JO

A pajtohet viktimë me përdorimin dhe shkëmbimin e të dhënave të saj personale në përputhje me ligjin dhe përmbajtjen e planit individual për mbrojtjen dhe forcimin e viktimës?

PO JO

Nëse PO për dy pyetjet e mëparshme,

- Nga se ka frikë viktimë? (rendisni të gjithë faktorët që ndikojnë që ajo ndihet e pasigurt jo vetëm nga kryerësi)
- Me kë mendon viktimë se është e sigurt për të biseduar?
- Me kë mendon viktimë se nuk është e sigurt për të biseduar?

Emri dhe mbiemri

Nënshkrimi

1. Të dhëna për viktimën, për fëmijën/fëmijët dhe për anëtarët e familjes së viktimës që janë në rrezik

	Të dhënat relevante për zbatimin e planit individual për mbrojtjen dhe fuqizimin e viktimës
Emri dhe mbiemri	
Të dhënat kontaktuese (telefon)	
Adresa e banimit/adresa aktuale	
Statusi martesor/marrëdhënia me dhunuesin	
Punësimi, burimi i të ardhurave	
Burimet personale dhe potenciali për mbështetje nga mjedisi familjar dhe social i viktimës	
Rrethanat që rrisin cenueshmërinë e viktimës dhe të dhëna të tjera relevante	
Të dhëna për fëmijën, anëtarët e familjes, dhe të dhënat kontaktuese	

2. Të dhëna për dhunën

DHUNA	PO	JO	Vërejtje
Aktuale			
Lëndim fizik			
Lëndim i rëndë fizik			
Lëndim fizik me sende dhe mjete			
Dhuna seksuale			
Dhuna psikike			
Kërcënimet për vrasje			
Kërcënimet për vetëvrasje			
Frikësimi, ndalimet, kontrolli shtrëngues dhe sjellja kontrolluese			
Fyerje verbale			
Sjellje abuzive			
Dhuna e mëparshme			
Dëmtimi i fëmijëve			
Dhuna ndodh në prani të fëmijëve			
Viktima mund të kontaktojë në mënyrë të sigurt			
Tjetër _____			
KRYERËSI (Emri dhe mbiemri, të dhënat kontaktuese, posedimi i licencës për armë zjarri dhe/ose armë zjarri, nëse është denoncuar më parë për dhunë në familje, punësim, njohuri rreth sëmundjeve të varësisë dhe shëndetit të çrregulluar mendor)	Vërejtje		
Rrethana të tjera të relevante për sigurinë e viktimës	Vërejtje		

3. Të dhëna për rrezikun dhe rrezikun e përsëritjes së dhunës

--

4. Masat mbrojtëse, masat e përkohshme mbrojtëse, dinamika dhe kohëzgjatja e masave në planin individual për mbrojtjen dhe forcimin e viktimës dhe detyrimi detyrën e zbatimit veçmas për secilin anëtar të ekipit.

Nr.	Masa	Dinamika	Kohëzgjatja (data e fillimit)	Personi përgjegjës (emri dhe mbiemri)
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				

Ekipi profesional,
nënshkrimet e anëtarëve

Data: _____

5. Vlerësimi i profesionistit për efektet e arritura të planit, përkatësisht se rreziku që justifikon zbatimin e planit për mbrojtjen dhe forcimin individual të viktimës ka pushuar, bazuar në rivlerësimin e rrezikut.

Vlerësimi i efekteve të planit me të dhëna për kohëzgjatjen e planit	Rivlerësimi i rrezikut me datë	Vlerësimi për zbatimin e mëtejshëm të planit individual për mbrojtjen dhe forcimin e viktimës

Ekipi profesional

Emri dhe mbiemri _____ nënshkrimi _____

Emri dhe mbiemri _____ nënshkrimi _____

Emri dhe mbiemri _____ nënshkrimi _____

Emri dhe mbiemri _____ nënshkrimi _____

Emri dhe mbiemri _____ nënshkrimi _____

Data _____

Shtojca nr. 4

Lista dhe kontaktet e anëtarëve të ekipit profesional multi-sektorial

IP QPS _____

Nr. _____

(Data dhe vendi)

Institucioni/organizata	Anëtarët dhe zëvendës anëtarët e Ekipit të Profesionistëve Multisektorial (Emri dhe mbiemri)	Të dhënat kontaktuese (adresa dhe nr.tel të zyrës e - mail adresa)	Të dhënat kontaktuese (telefon celular)	Të dhënat kontaktuese jashtë orarit të punës

Shtojca nr. 5

IP QPS _____

Nr. _____

(Data dhe vendi)

Plani i sigurisë për mbrojtjen dhe fuqizimin e viktimës

Informimi dhe pëlqimi i viktimës për planin e sigurisë për mbrojtjen dhe fuqizimin e viktimës

1. A është viktimja e informuar për planin e sigurisë për mbrojtjen dhe fuqizimin e viktimës dhe përmbajtjen e tij?

PO

JO

2. A pajtohet viktimja me mbledhjen e ekipit të profesionistëve multisektorial, përdorimin dhe shkëmbimin e të dhënave të saj personale në përputhje me ligjin dhe përmbajtjen e planit të sigurisë për mbrojtjen dhe forcimin e viktimës?

PO

JO

Nëse PO për dy pyetjet e mëparshme,

3. Nga se ka frikë viktimja? (rendisni të gjithë faktorët që ndikojnë që ajo ndihet e pasigurt jo vetëm nga kryerësi)

Me kë mendon viktimja se është e sigurt për të biseduar?

Me kë mendon viktimja se nuk është e sigurt për të biseduar?

Data

Emri dhe mbiemri

Nënshkrimi

1. Të dhëna për viktimën, fëmijën/fëmijët dhe anëtarët e familjes së viktimës që janë në rrezik

Emri dhe mbiemri dhe të dhënat kontaktuese	Të dhënat përkatëse për zbatimin e planit të sigurisë për mbrojtjen dhe forcimin e viktimës (<i>gjinia, mosha, statusi martesor, marrëdhënia me dhunuesin, punësimi, burimi i të ardhurave, burimet personale dhe potenciali për mbështetje nga mjedisi familjar dhe social i viktimës, gjendja e strehimit, rrethanat që rrisin cenueshmërinë e viktimës dhe të dhëna të tjera relevante</i>)

2. Të dhëna për dhunën

DHUNA	PO	JO	Vërejtje
Aktuale			
Lëndim fizik			
Lëndim i rëndë fizik			
Lëndim fizik me mjete dhe sende			
Dhuna seksuale			
Dhuna psikike			
Kërcënime me vdekje			
Kërcënime për vetëvrasje			
Frikësimi, ndalimet, kontrolli shtrëngues dhe sjellje kontrolluese			
Fyerje verbale			
Sjellje abuzive			
Dhuna e mëparshme			
Dëmtimi i fëmijëve			
Dhuna ndodh në prani të fëmijëve			
Viktima mund të kontaktojë në mënyrë të sigurt			
Tjetër _____			
KRYERËSI	Vërejtje		
<i>(Emri dhe mbiemri, të dhënat kontaktuese, posedimi i licencës për armë zjarri dhe/ose armë zjarri, nëse është denoncuar më parë për dhunë në familje, punësim, njohuri rreth sëmundjeve të varësisë dhe shëndetit të çrregulluar mendor)</i>			
Rrethana të tjera të relevante për sigurinë e viktimës	Vërejtje		

3. Të dhëna për rrezikun e përsëritjes së dhunës

--

4. Masat e ndihmës, dinamika dhe kohëzgjatja e masave në planin e sigurisë për mbrojtjen dhe forcimin e viktimës dhe detyrimi për zbatimin veçmas për çdo anëtar të ekipit

Nr.	Masa	Dinamika	Kohëzgjatja (data e fillimit)	Personi përgjegjës (emri dhe mbiemri)
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				

Nënshkrimet e anëtarëve të ekipit të profesionistëve multi-sektorial

Data: _____

5. Vlerësimi i ekipit të profesionstëve multi-sektorial mbi efektet e arritura të planit, përkatësisht rreziku që justifikon zbatimin e planit të sigurisë, është ndërprerë, bazuar në rivlerësimin e rrezikut.

Vlersimi i efekteve të planit me të dhënat për kohëzgjatjen e planit të sigurisë për mbrojtjen dhe përforcimin e viktimës	Rivlerësimi i rrezikut me datë	Vlerësimi për zbatimin e mëtejshëm të planit të sigurisë për mbrojtjen dhe përforcimin e viktimës

Ekipi profesional multi-sektorial

Emri dhe mbiemri _____ nënshkrimi _____

Emri dhe mbiemri _____ nënshkrimi _____

Emri dhe mbiemri _____ nënshkrimi _____

Emri dhe mbiemri _____ nënshkrimi _____

Emri dhe mbiemri _____ nënshkrimi _____

Data _____

Shtojca nr. 6

IP QPS _____

Nr. _____

(Data dhe vendi)

Lista për monitorimin e masave mbrojtëse nga plani i sigurisë

Nr.	Masa dhe statusi i zbatimit	Data dhe nënshkrimi i profesionistit në qendër
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		
6.		
7.		
8.		
9.		
10.		